

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË**  
**Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve**

**PROGRAMI**  
**I KURSIT TË UNIFIKUAR**  
**“ESTETIKE”**

**Kodi: PK-AA-2-18**

Miratoi:

**MINISTRI**

.....

**Tiranë, 2018**

# PROGRAMI I KURSIT TË UNIFIKUAR

## “ESTETIKE”

(PK-AA-2-18)

### I. Profili Profesional i estetistit

#### a) *Karakteristikat e estetistit*

Estetisti është i aftë të kryejë *detyra* profesionale si i punësuar në qendra estetike apo sallone bukurie apo si i vetpunësuar për të ofruar shërbimet që kanë të bëjnë me trajtimin estetik të fytyrës dhe trupit të klientëve.

Për realizimin me sukses të këtyre detyrave, estetisti duhet që të zotërojë *njohuri* profesionale që kanë të bëjnë me konceptet dhe procedurat bazë, si dhe *shprehi* profesionale që lidhen me veprimtarinë profesionale të estetikës.

Suksesi i estetistit është i lidhur ngushtë dhe me *sjellje* (qëndrime) të tilla si: gjakftohtësia, shkathhtësia, qetësia, kujdesi, përqendrimi, mospërdorimi i pijeve alkoolike, korrektësia, disiplina etj., sjellje që e ndihmojnë atë të plotësojë kërkesat dhe përballojë vështirësitë e punës.

#### b) *Mundësitë e punësimit dhe karriera profesionale e estetistit*

Profesioni i estetistit është i lidhur ngushtë me procedurat e punës për trajtimin estetik të fytyrës dhe trupit të klientëve. Ai mund të punësohet ose vetpunësohet në sallone bukurie, qendra estetike, parukeri dhe biznese apo institucione të tjera që e ofrojnë ose e kërkojnë këtë shërbim.

Një individ mund të ushtrojë veprimtarinë e estetisti fillimisht si ndihmës estetist. Me përvojë pune dhe me kualifikime shtesë mund të përparojë profesionalisht në nivelin e estetistit të kualifikuar. Më pas, nëpërmjet kualifikimit të mëtejshëm në shkollat profesionale apo trajnimin nëpërmjet punës, një estetist mund të ndër marrë disa funksione mbikëqyrëse duke ngritur shkallët e karrierës si menaxher i një biznesi të estetikës.

Për të zhvilluar aktivitet privat në sektorin e estetikës, duhet regjistrimi për ushtrim aktiviteti si person fizik apo juridik, sipas rastit.

Ky kurs i përgatit kursantët me kompetenca profesionale për të ushtruar veprimtari profesionale të përfshira në njësinë “Kozmetologë dhe profesione që lidhen me të”, me kod 5142, referuar Listës Kombëtare të Profesioneve.

### II. Kompetencat që fitojnë kursantët në përfundim të Kursit për estetikë

Në përfundim të Kursit për estetikë, kursantët do të jenë të aftë të:

- Bëjnë organizimin e vogël të punës në qendrën/sallonin e estetikës.
- Përdorin dhe interpretojnë dokumentacionin e estetikës
- Përzgjedhin dhe përdorin mjetet, pajisjet dhe materialet e duhura të punës.
- Mirëmbajnë mjetet, materialet, pajisjet dhe mjedisin e punës.
- Kryejnë trajtimet e fytyrës
- Kryejnë trajtimet e trupit
- Kryejnë masazhime të fytyrës
- Kryejnë masazhime të trupit
- Kryejnë depilime

- Kryejnë trukime (makiازه)
- Këshillojnë klientët për dietën dhe mirëmbajtjen e trupit
- Zbatojnë rregullat dhe kërkesat e trajtimeve estetike
- Zbatojnë rregullat e sigurimit teknik, higjienës dhe të ruajtjes së mjedisit në mjediset e punës.
- Komunikojnë me etikë profesionale.

### III. Kërkesat e pranimit në Kursin për estetikë.

Pjesmarrësit në Kursin për estetikë duhet të jenë mbi 18 vjeç, të kenë përfunduar arsimin e mesëm.

### IV. Kohëzgjatja e Kursit për estetikë

360 orë mësimore, ku

1 orë mësimore = 45 minuta

### V. Modulet e Kursit për estetikë

Nr	Titulli i Modullit	Kodi	Kohëzgjatja	Rezultatet Mësimore
1	Hyrje në profesionin e estetikës	MK-32-126-18	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori 10% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të estetikës. 2. Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës së estetistit. 3. Kursanti përshkruan rregullat etikës, të higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit 4. Përshkruan anatominë dhe fiziologjinë e lëkurës dhe muskulaturës së njeriut
2	Trajtimi dhe masazhimi i fytyrës	MK-32-127-18	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e trajtimeve dhe masazhimeve të fytyrës. 2. Kursanti trajton dhe masazhon fytyrën.
3	Trajtimi dhe masazhimi i trupit	MK-32-128-18	120 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e trajtimeve dhe masazhimeve të trupit. 2. Kursanti trajton dhe masazhon trupin.
4	Depilimi	MK-32-129-18	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	1. Kursanti përshkruan veçoritë e depilimit 2. Kursanti kryen depilimin me krem depilator. 3. Kursanti kryen depilimin me çeretë.

5	Trukimi	MK-32-130-18	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori 80% Praktikë 10% Vlerësime	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Kursanti përshkruan veçoritë trukimit</li> <li>2. Kursanti kryen trukimin bazik</li> <li>3. Kursanti kryen trukimin e ditës dhe të mbrëmjes</li> <li>4. Kursanti kryen trukimin e festiv, skenik dhe fotografik.</li> <li>5. Kursanti kryen formësimin, lyerjen e vetullës dhe shtimin e qerpikëve.</li> </ol>
---	---------	--------------	--	--

## VI. Vlerësimi dhe Çertifikimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

## VII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit për estetikë

### 1. Moduli “Hyrje në profesionin e estetikës”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
<b>Titulli dhe kodi</b>	<b>HYRJE NE PROFESIONIN E ESTETIKES</b>	<b>MK-32-126-18</b>
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e profesionit të estetistit, me mjedisin dhe mjetet e punës së estetistit, me rregullat e etikës, të higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit, si dhe me veçoritë anatomike dhe fiziologjike të lëkurës dhe muskulaturës së njeriut.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	30 orë mësimore Rekomandohet: 80% Teori; 10% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm dhe të jenë mbi 18 vjeç	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e profesionit të estetikës.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të argumentojë historikun, qëllimin dhe rëndësinë e shërbimeve të estetikës për individin;</li><li>- të përshkruajë funksionet, detyrat dhe veprimtaritë kryesore të punës së estetistit.</li><li>- të përshkruajë mjediset, mënyrën e organizimit dhe kushtet e punës së estetistit.</li><li>- të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe makineritë që përdor estetisti.</li><li>- të përshkruajë proceset bazë të veprimtarisë së estetistit.</li><li>- të tregojë organizimin e punës në një qendër estetike.</li><li>- të tregojë si organizohet grafiku i takimeve për shërbimet në një qendër estetike.</li><li>- të përshkruajë ndërtimin dhe mënyrën e plotësimit të bazës së të dhënave të klientit;</li><li>- të përshkruajë kërkesat profesionale për estetistin.</li><li>- të tregojë mundësitë e punësimit dhe të karrierës profesionale të estetistit.</li><li>- të përshkruajë kuadrin ligjor të veprimtarisë së estetikës;</li><li>- të përshkruajë kërkesat për liçensim për ushtrimin e veprimtarisë së estetistit;</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Pyetje përgjigje me gojë.</li><li>- Pyetje përgjigje me shkrim.</li></ul>	
	<p><b>RM 2 Kursanti përshkruan mjedisin, veglat, pajisjet dhe materialet e punës së estetistit.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Kursanti duhet të jetë i aftë :</p>	

- të përshkruajë mjedisin e një qendre apo salloni estetike;
- të organizojë dhe mirëmbajë mjedisin e punës së estetistit;
- të përshkruajë dhe të dallojë veglat, mjetet dhe pajisjet e punës së estetistit;
- të tregojë përdorimet e veglave, mjeteve dhe pajisjeve të estetistit;
- të mirëmbajë veglat, mjetet dhe pajisjet e estetistit;
- të dallojë dhe tregojë përdorimet e materialeve të punës në veprimtarinë e estetistit;
- të interpretojë etiketat dhe udhëzimet e prodhuesit për materialet e punës së estetistit.
- të sistemojë dhe mirëmbajë materialet e punës së estetistit;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje - përgjigje me gojë.
- Pyetje - përgjigje me shkrim.

**RM 3 Kursanti përshkruan rregullat e etikës, të higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë veçoritë e tipeve të ndryshme të klientëve;
- të dallojë tipet e ndryshme të klientëve;
- përshkruajë rregullat e komunikimit me etikë profesionale me klientët, eprorët, kolegët etj.;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e higjienës personale
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e higjienës personale, klientit, mjedisit dhe mjeteve të punës;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e sigurisë së klientit dhe të mjedisit të punës;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e mbrojtjes nga zjarri, nga rryma elektrike dhe nga rreziqe të tjera;
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e ruajtjes dhe përdorimit të materialeve dhe mjeteve të estetikës;
- të tregojë përdorimin e kutisë së ndihmës së shpejtë dhe mënyrën e dhënies së ndihmës së parë për të dëmtuarit.
- të përshkruajë dhe të zbatojë rregullat e mbrojtjes së mjedisit në repartin e estetikës;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Vëzhgim me listë kontrolli.

**RM 4 Kursanti përshkruan anatominë dhe fiziologjinë e lëkurës dhe muskulaturës së njeriut.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë :

- të përshkruajë ndërtimin e përgjithshëm të trupit të njeriut;
- të përshkruajë veçoritë e llojeve të ndryshme të lëkurës së njeriut;

- të përshkruajë ndërtimin dhe fiziologjinë e lëkurës;
- të përshkruajë veçoritë e llojeve të ndryshme të muskulaturës së njeriut;
- të përshkruajë ndërtimin dhe fiziologjinë e muskulaturës;
- të përshkruajë ndikimin e anatomisë dhe fiziologjisë së lëkurës dhe muskulaturës në aspektet estetike të njeriut.

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Pyetje përgjigje me gojë.
- Pyetje përgjigje me shkrim.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së qendrës së estetikës. Rekomandohen dhe vizita në biznese që kryejnë veprimtari të estetikës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në qendër estetike. Atyre duhet ti jepen detyra të përshkruajnë veçoritë e profesionit të estetistit, me funksionet, detyrat dhe veprimtaritë ku mbështetet puna e estetistit. Ata duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi të verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
  - Mjedise reale të punës në qendër estetike.
  - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në qendër estetike.
  - Manikinë estetike.
  - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

## 2. Moduli “Trajtimi dhe masazhimi i fytyrës”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	TRAJTIMI DHE MASAZHIMI I FYTYRES	MK-32-127-18
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e dhe procedurat e trajtimit dhe masazhimit të fytyrës, si dhe i aftëson ata që të kryejnë trajtime dhe masazhime të ndryshme të fytyrës.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e estetikës”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e trajtimeve dhe masazhimeve të fytyrës.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të argumentojë qëllimin dhe rëndësinë e trajtimeve dhe masazhimeve të fytyrës;</li><li>- të përshkruajë llojet e trajtimeve të fytyrës dhe masazhet përkatëse;</li><li>- të përshkruajë procedurat për trajtimin e fytyrës dhe masazhimin përkatës;</li><li>- të tregojë veglat, pajisjet dhe materialet për trajtimin dhe masazhimin e fytyrës;</li><li>- të përzgjedhë dhe tregojë përdorimet e produkteve të ndryshme që përdoren për trajtimin dhe masazhimin e fytyrës.</li><li>- të organizojë grafikun e takimeve dhe bazën e të dhënave të klientëve;</li><li>- të përshkruajë rregullat e komunikimit, të higjienës, të sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit gjatë trajtimit dhe masazhimit të fytyrës;</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Pyetje përgjigje me gojë.</li><li>- Pyetje përgjigje me shkrim.</li></ul> <p><b>RM 2 Kursanti trajton dhe masazhon fytyrën.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përgatisë klientin për trajtimin dhe masazhimin e fytyrës;</li><li>- të marrë informacion paraprak nga klienti;</li><li>- të analizojë llojin dhe gjendjen e lëkurës dhe muskulaturës së fytyrës së klientit;</li><li>- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për trajtimin dhe masazhimin e fytyrës;</li></ul>	



- të përzgjedhë produktet e duhura në varësi të lëkurës;
- të përzgjedhë procedurat e trajtimit të lëkurës së fytyrës dhe masazhimin përkatës;
- të zbatojë kërkesat e higjienës personale, të klientëve dhe të mjeteve të punës.
- të realizojë trajtimin e fytyrës me avull
- të realizojë trajtimin e fytyrës me skrab
- të realizojë trajtimin e fytyrës me maskë
- të realizojë trajtimin e fytyrës me maskë argjili
- të realizojë trajtimin e fytyrës me serum
- të realizojë trajtimin e fytyrës me krem
- të realizojë trajtimin e fytyrës anti-age
- të realizojë trajtimin e fytyrës me yndyrë
- të realizojë trajtimin e fytyrës së thatë
- të kryejë masazhimet përkatëse të fytyrës, në varësi të llojit të trajtimit të fytyrës;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.
- të bëjë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit financiar për shërbimin e kryer;
- të kryejë regjistrimet në bankën e të dhënave të klientit.
- të këshillojë klientin për kujdesin e mëtejshëm;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së repartit të estetikës. Rekomandohen dhe vizita dhe praktika në biznese që kryejnë veprimtari të estetikës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe e simulimit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin e estetikës. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për trajtimin dhe masazhimin e fytyrës me teknika të ndryshme, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit

---

**Kushtet e domosdoshme**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

---

---

**për realizimin e  
modulit**

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
  - Mjedise reale të punës në qendër estetike.
  - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve për të kryer trajtimin dhe masazhimin e fytyrës, në qendër estetike.
  - Produkte për trajtimin e fytyrës.
  - Manikinë estetike.
  - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-

### 3. Moduli “Trajtimi dhe masazhimi i trupit”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	TRAJTIMI DHE MASAZHIMI I TRUPIT	MK-32-128-18
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e dhe procedurat e trajtimit dhe masazhimit të trupit, si dhe i aftëson ata që të kryejnë trajtime dhe masazhime të ndryshme të trupit.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	120 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulin “Hyrje në profesionin e estetikës”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<p><b>RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e trajtimeve dhe masazhimeve të trupit.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Kursanti duhet të jetë i aftë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të argumentojë qëllimin dhe rëndësinë e trajtimeve dhe masazhimeve të trupit;</li><li>- të përshkruajë llojet e trajtimeve të trupit dhe masazhet përkatëse;</li><li>- të përshkruajë procedurat për trajtimin e trupit dhe masazhimin përkatës;</li><li>- të tregojë veglat, pajisjet dhe materialet për trajtimin dhe masazhimin e trupit;</li><li>- të përzgjedhë dhe tregojë përdorimet e produkteve të ndryshme që përdoren për trajtimin dhe masazhimin e trupit.</li><li>- të organizojë grafikun e takimeve dhe bazën e të dhënave të klientëve;</li><li>- të përshkruajë rregullat higjienës, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë trajtimit dhe masazhimit të trupit;</li></ul> <p><b>Instrumentet e vlerësimit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Pyetje përgjigje me gojë.</li><li>- Pyetje përgjigje me shkrim.</li></ul>	
	<p><b>RM 2 Kursanti trajton dhe masazhon trupin</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Kursanti duhet të jetë i aftë :</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- të përgatisë klientin për trajtimin dhe masazhimin e trupit</li><li>- të marrë informacion paraprak nga klienti;</li><li>- të analizojë llojin dhe gjendjen e lëkurës dhe të muskulaturës së trupit të klientit;</li><li>- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për trajtimin dhe masazhimin e trupit.</li><li>- të përzgjedhë produktet e duhura në varësi të lëkurës;</li><li>- të përzgjedhë procedurat e trajtimit të lëkurës së trupit dhe</li></ul>	

- masazhimet përkatës;
- të zbatojë kërkesat e higjienës personale, të klientëve dhe të mjeteve të punës.
  - të realizojë trajtimin e trupit me skrab
  - të realizojë trajtimin e trupit me vaj argani dhe kokosi
  - të realizojë trajtimin e trupit me krem
  - të realizojë trajtimin e trupit me maska çokollate
  - të realizojë trajtimin e trupit me maskë argjili
  - të realizojë trajtimin e trupit me baltë (fango)
  - të kryejë masazhimet përkatëse në varësi të llojit të trajtimit të trupit;
  - të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.
  - të bëjë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit financiar për shërbimin e kryer;
  - të kryejë regjistrimet në bankën e të dhënave të klientit.
  - të këshillojë klientin për kujdesin e mëtejshëm;
  - të komunikojë me etikë profesionale;
  - të zbatojë rregullat e sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Instrumentet e vlerësimit:**
- Vëzhgim me listë kontrolli
  - Pyetje përgjigje me gojë.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së repartit të estetikës. Rekomandohen dhe vizita dhe praktika në biznese që kryejnë veprimtari të estetikës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe e simulimit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin e estetikës. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për trajtimin dhe masazhimin e trupit me teknika të ndryshme, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
  - Mjedise reale të punës në qendër estetike.
  - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve
-

---

për të kryer trajtimin dhe masazhimin e trupit, në qendër estetike.

- Produkte për trajtimin e trupit.
- Manikinë estetike.

Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.

---

#### 4. Moduli “Depilimi”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	DEPILIMI	MK-32-129-18
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e depilimit, si dhe i aftëson ata të kryejnë depilime të ndryshme me krem depilator dhe me çeretë.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	50 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e estetikës”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RM I Kursanti përshkruan veçoritë e depilimit.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të argumentojë qëllimin dhe rëndësinë e depilimit të pjesëve të trupit dhe fytyrës së njeriut.</li><li>- të përshkruajë llojet dhe teknikat e depilimit të trupit dhe fytyrës.</li><li>- të përshkruajë procedurat për kryerjen e depilimit të trupit dhe fytyrës.</li><li>- të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe materialet për depilimin e trupit dhe fytyrës.</li><li>- të përshkruajë llojet, ndërtimin dhe përdorimin e pajisjeve të depilimit me rreze lazer.</li><li>- të për zgjedhë dhe tregojë përdorimet e produkteve të ndryshme që përdoren për depilimin e trupit dhe fytyrës.</li><li>- të përshkruajë rregullat e përdorimit të pajisjeve dhe materialeve për depilimin e fytyrës dhe të trupit.</li><li>- të organizojë grafikun e takimeve dhe bazën e të dhënave të klientëve;</li><li>- të tregojë organizimin e punës zinxhir në sallon deri në procesin përfundimtar të depilimit.</li><li>- të përshkruajë rregullat e higjienës, sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit gjatë depilimit të fytyrës dhe trupit.</li></ul> <b>Instrumentet e vlerësimit:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Pyetje përgjigje me gojë.</li><li>- Pyetje përgjigje me shkrim.</li></ul>	
	<b>RM 2 Kursanti kryen depilimin me krem depilator.</b> <b>Kriteret e vlerësimit:</b> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të veshë uniformën e duhur për kryerjen e depilimit.</li><li>- të përgatisë klientin për depilimin me krem depilator;</li><li>- të konsultohet dhe të marrë informacion paraprak nga klienti;</li><li>- të analizojë dhe diagnostikojë gjendjen e lëkurës dhe</li></ul>	

- qimeve të klientit, ku do të kryhet depilimi me krem;
- të përzgjedhë procedurat e depilimit;
- të zbatojë kërkesat e higjienës personale, të klientëve dhe të mjeteve të punës;
- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për depilimin me krem;
- të përzgjedhë kremi depilator dhe produktet e tjera që do të përdoren për depilimin;
- të përgatitë kremi depilator dhe materialet e tjera ndihmëse për kryerjen e depilimit;
- të vendosë kremi e depilimit në lëkurën e klientit.
- të kryejë heqjen e kremit me pambuk ose peshqir;
- të vendosë kremi hidratues pas përfundimit të depilimit.
- të këshillojë klientin për mirëmbajtjen e lëkurës pas depilimit, duke i rekomanduar kremi e duhur;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.
- të bëjë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dukumentacionit financiar për shërbimin e kryer;
- të kryejë regjistrimet në bankën e të dhënave të klientit;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë.

**RM 3 Kursanti kryen depilimin me çeretë.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur për kryerjen e depilimit.
- të përgatisë klientin për depilimin me çeretë;
- të konsultohet dhe të marrë informacion paraprak nga klienti;
- të analizojë dhe diagnostikojë gjendjen e lëkurës dhe të qimeve të klientit, ku do të kryhet depilimi me çeretë;
- të përzgjedhë procedurat e depilimit;
- të zbatojë kërkesat e higjienës personale, të klientëve dhe të mjeteve të punës;
- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për depilimin me çeretë;
- të përzgjedhë çerën (dyllin) dhe produktet e tjera që do të përdoren për depilimin;
- të kryejë shkrirjen e dyllit;
- të vendosë çerën në pozicionin e duhur;
- të kryejë heqjen e çerës me letrën ngjitëse në drejtimin e kundërt të qimes;
- të vendosë vajin dhe të masazhojë pjesët e depiluara për zbutjen e lëkurës;
- të këshillojë klientin për mirëmbajtjen e lëkurës pas depilimit, duke i rekomanduar produktet e duhura;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.
- të bëjë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dukumentacionit financiar për shërbimin e kryer;

- të kryejë regjistrimet në bankën e të dhënave të klientit;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së repartit të estetikës. Rekomandohen dhe vizita dhe praktika në biznese që kryejnë veprimtari të estetikës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe e simulimit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin e estetikës. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për depilimin e trupit dhe fytyrës me teknika të ndryshme, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuar për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e domosdoshme për realizimin e modulit**

- Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:
- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
  - Mjedise reale të punës në qendër estetike.
  - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në qendër estetike.
  - Kremëra depilues, çera të ndryshme, letra ngjitëse, vajra hidratues etj.
  - Kremëra të ndryshëm për fytyrën dhe trupin.
  - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul.
-



## 5. Moduli “Trukimi”

<i>PERSHKRUESI I MODULIT</i>		
Titulli dhe kodi	TRUKIMI	MK-32-130-18
<b>Qëllimi i modulit</b>	Një modul që i njeh kursantët me veçoritë e trukimit, si dhe i aftëson ata të kryejnë trukimin bazik, trukimin e ditës dhe të mbrëmjes, trukimin festiv, skenik dhe fotografik, formësimin, lyerjen e vetullës dhe shtimin e qerpikëve.	
<b>Kohëzgjatja e modulit</b>	80 orë mësimore Rekomandohet: 10% Teori; 80% Praktikë; 10% Vlerësime	
<b>Niveli i parapëlqyer për pranim</b>	Kursantët duhet të kenë përfunduar arsimin e mesëm, të jenë mbi 18 vjeç dhe të kenë kryer modulën “Hyrje në profesionin e estetikës”.	
<b>Rezultatet e të mësuarit (RM) dhe procedurat e vlerësimit</b>	<b>RM 1 Kursanti përshkruan veçoritë e trukimit</b> <b><i>Kriteret e vlerësimit:</i></b> Kursanti duhet të jetë i aftë: <ul style="list-style-type: none"><li>- të përshkruajë historikun, qëllimin dhe rëndësinë e trukimit të njeriut.</li><li>- të përshkruajë llojet, veçoritë dhe teknikat e trukimeve të ndryshme.</li><li>- të përshkruajë procedurat për kryerjen e trukimeve të ndryshme.</li><li>- të përshkruajë mjetet, pajisjet dhe materialet për trukimin.</li><li>- të përshkruajë llojet, ndërtimin dhe përdorimin e pajisjeve</li><li>- të për zgjedhë dhe tregojë përdorimet e produkteve të ndryshme që përdoren për trukimet e ndryshme.</li><li>- të përshkruajë rregullat e përdorimit të pajisjeve dhe materialeve që përdoren për trukimet.</li><li>- të organizojë grafikun e takimeve dhe bazën e të dhënave të klientëve;</li><li>- të tregojë organizimin e punës zinxhir në sallon deri në procesin përfundimtar të trukimit.</li></ul> <b><i>Instrumentet e vlerësimit:</i></b> <ul style="list-style-type: none"><li>- Pyetje përgjigje me gojë.</li><li>- Pyetje përgjigje me shkrim.</li></ul> <b>RM 2 Kursanti kryen trukimin bazik</b> <b><i>Kriteret e vlerësimit:</i></b> Kursanti duhet të jetë i aftë : <ul style="list-style-type: none"><li>- të veshë uniformën e duhur për kryerjen e trukimit.</li><li>- të përgatisë klientin për trukimin bazik;</li><li>- të konsultohet dhe të marrë informacion paraprak nga klienti për qëllimin e trukimit;</li><li>- të analizojë llojin dhe gjendjen e lëkurës së fytyrës së klientit (normale, e thatë, e yndyrshme e përzier);</li><li>- të analizojë formën e fytyrës (ovale, katrore, drejtkëndore,</li></ul>	

- trekëndëshe, rrethore, diamanti, zemre);
- të dëgjojë dhe të respektojë dëshirat, shijet dhe kërkesat e klientit dhe të japi këshillat profesionale sipas rastit;
- të përzgjedhë procedurat dhe produktet e duhura të trukimit, në varësi të gjendjes së lëkurës dhe formës së fytyrës;
- të identifikojë nevojat për përmirësim të pamjes së fytyrës, të syve, hundës, buzëve, mollëzave e vetullave;
- të zbatojë kërkesat e higjienës personale, të klientëve dhe të mjeteve të punës;
- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për trukimin bazik;
- të përzgjedhë produktet e duhura për trukimin bazik;
- të realizojë pastrimin paraprak të fytyrës;
- të kryejë procedurat e trukimit të fytyrës, syve, hundës, buzëve, mollëzave dhe vetullave, me përdorimin e mjeteve, produkteve dhe teknikave përkatëse;
- të konsultohet vazhdimisht me klientin gjatë realizimit të trukimit bazik;
- të këshillojë klientin për kujdesin e mëtejshëm;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.
- të bëjë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dukumentacionit financiar për shërbimin e kryer;
- të kryejë regjistrimet në bankën e të dhënave të klientit;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë

**RM 3 Kursanti kryen trukimin e ditës dhe të mbrëmjes**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur për kryerjen e trukimit.
- të përgatisë klientin për trukimin e ditës dhe të mbrëmjes;
- të konsultohet dhe të marrë informacion paraprak nga klienti për qëllimin e trukimit;
- të analizojë llojin dhe gjendjen e lëkurës së fytyrës së klientit;
- të analizojë formën e fytyrës së klientit;
- të dëgjojë dhe të respektojë dëshirat, shijet dhe kërkesat e klientit dhe të japi këshillat profesionale sipas rastit;
- të përzgjedhë procedurat dhe produktet e duhura të trukimit të ditës ose të mbrëmjes, në varësi të gjendjes së lëkurës dhe formës së fytyrës;
- të identifikojë nevojat për përmirësim të pamjes së fytyrës, të syve, hundës, buzëve, mollëzave e vetullave;
- të zbatojë kërkesat e higjienës personale, të klientëve dhe të mjeteve të punës;
- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për trukimin e ditës ose të mbrëmjes;

- të përzgjedhë produktet e duhura për trukimin ditës ose të mbrëmjes;
- të përshtasë llojin dhe ngjyrën e make up;
- të formësojë dhe të lyejë vetullën;
- të trukojë sytë sipas nevojës;
- të trukojë mollëzat;
- të formësojë dhe të lyejë buzët;
- të lyejë dhe theksojë qerpikët;
- të theksojë apo t'i shtojë ndriçim syve, mollëzave ose buzëve për rastin e trukut të mbrëmjes;
- të konsultohet vazhdimisht me klientin gjatë realizimit të trukimit të ditës ose të mbrëmjes;
- të këshillojë klientin për heqjen e trukut, hidratimin e lëkurës pas heqjes së tij dhe për kujdesin e mëtejshëm;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.
- të bëjë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit financiar për shërbimin e kryer;
- të kryejë regjistrimet në bankën e të dhënave të klientit;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë

**RM 4 Kursanti realizon trukimin festiv, skenik dhe fotografik.**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur për kryerjen e trukimit.
- të përgatisë klientin për trukimin festiv, skenik ose fotografik;
- të konsultohet dhe të marrë informacion paraprak nga klienti për qëllimin e trukimit;
- të analizojë llojin dhe gjendjen e lëkurës së fytyrës së klientit;
- të analizojë formën e fytyrës së klientit;
- të dëgjojë dhe të respektojë dëshirat, shijet dhe kërkesat e klientit dhe të japi këshillat profesionale sipas rastit;
- të përzgjedhë procedurat dhe produktet e duhura të trukimit festiv, skenik ose fotografik, në varësi të gjendjes së lëkurës dhe formës së fytyrës;
- të identifikojë nevojat për ndryshim të pamjes së fytyrës, të syve, hundës, buzëve, mollëzave e vetullave;
- të zbatojë kërkesat e higjienës personale, të klientëve dhe të mjeteve të punës;
- të përzgjedhë veglat dhe mjetet për festiv, skenik ose fotografik;
- të përzgjedhë produktet e duhura për trukimin ditës ose të mbrëmjes;
- të pastrojë fytyrën;
- të vendosi bazën e make up;

- të përshtasë llojin dhe ngjyrën e make up;
- të bëjë shpërdarjen uniforme të make up me furçë ose me sfungjer;
- të bëjë prerjet horizontale dhe vertikale;
- të formësojë dhe të lyejë vetullën;
- të truckojë sytë sipas nevojës me hije, me penel të zi me penel të bardhë;
- të shpërndajë pudrën pluhur për të shmangur yndyrosjen;
- të ngjisë qerpikët për gjatësi apo volum një e nga një ose njëtrupëshe;
- të theksojë ose të zbusi këndet e fytyrës;
- të theksojë dhe lyejë mollëzat;
- të formësojë dhe të lyejë buzët;
- të fshehë ose të zmadhojë në mënyrë të ekzagjeruar tipare të fytyrës për rase karnavalesh apo festash;
- të zbukurojë me elementë të ndryshëm, gurë apo pudra me ndriçim, pjesë të ndryshme të fytyrës apo trupit;
- të shpërndajë në mënyrë të njëtrajtëshme mbi truk fiksuesin e trukut;
- të konsultohet vazhdimisht me klientin gjatë realizimit të trukimit festiv, skenik ose fotografik;
- të këshillojë klientin për heqjen e trukut dhe për kujdesin e mëtejshëm;
- të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.
- të bëjë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dokumentacionit financiar për shërbimin e kryer;
- të kryejë regjistrimet në bankën e të dhënave të klientit;
- të komunikojë me etikë profesionale;
- të zbatojë rregullat sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit;

***Instrumentet e vlerësimit:***

- Vëzhgim me listë kontrolli
- Pyetje përgjigje me gojë;

**RM 5 Kursanti kryen formësimin, lyerjen e vetullës dhe shtimin e qerpikëve**

***Kriteret e vlerësimit:***

Kursanti duhet të jetë i aftë:

- të veshë uniformën e duhur për kryerjen e trukimit.
- të përgatisë klientin për formësimin, lyerjen e vetullës ose shtimin e qerpikëve;
- të konsultohet dhe të marrë informacion paraprak nga klienti për qëllimin e trukimit;
- të analizojë llojin dhe gjendjen e lëkurës së fytyrës së klientit;
- të analizojë formën e fytyrës së klientit;
- të dëgjojë dhe të respektojë dëshirat, shijet dhe kërkesat e klientit dhe të japi këshillat profesionale sipas rastit;
- të përzgjedhë procedurat dhe produktet e duhura për formësimin, lyerjen e vetullës ose shtimin e qerpikëve, në varësi të gjendjes së lëkurës dhe formës së fytyrës;

- të identifikojë nevojat për ndryshimin e pamjes së klientit;
  - të zbatojë kërkesat e higjienës personale, të klientit dhe të mjeteve të punës;
  - të përzgjedhë veglat dhe mjetet për formësimin, lyerjen e vetullës ose shtimin e qerpikëve;
  - të përzgjedhë produktet e duhura për formësimin, lyerjen e vetullës ose shtimin e qerpikëve;
  - të përshtasë llojin e vetullës me formën e fytyrës;
  - të formësojë me pincetë, me pe ose me dyll dhe të lyejë vetullën;
  - të ngjisë me lëngun përkatës fije ose tufa jo natyrale dhe natyrale mbi qerpikët e klientit, për një kohë deri në tre ose katër javë;
  - të ngjisë me lëngun përkatës qerpikë në formë trupi mbi qerpikun e klientit për një ose dy ditë;
  - të këshillojë klientin për kujdesin për këta lloje qerpikësh;
  - të heqë qerpikët e shtuar me lëngun përkatës;
  - të konsultohet vazhdimisht me klientin gjatë realizimit të formësimin, lyerjen e vetullës ose shtimin e qerpikëve;
  - të këshillojë klientin për kujdesin e mëtejshëm;
  - të përdorë dhe mirëmbajë mjetet dhe materialet e punës.
  - të bëjë llogaritjet ekonomike dhe plotësimin e dukumentacionit financiar për shërbimin e kryer;
  - të kryejë regjistrimet në bankën e të dhënave të klientit;
  - të komunikojë me etikë profesionale;
  - të zbatojë rregullat sigurisë dhe të mbrojtjes së mjedisit;
- Instrumentet e vlerësimit:**
- Vëzhgim me listë kontrolli
  - Pyetje përgjigje me gojë.

---

**Udhëzime për zbatimin e modulit**

- Ky modul duhet të trajtohet në klasë mësimore dhe në mjediset e punës së repartit të estetikës. Rekomandohen dhe vizita dhe praktika në biznese që kryejnë veprimtari të estetikës.
- Instruktori i praktikës duhet të përdorë sa më shumë të jetë e mundur shpjegimet të ilustruara me materiale pamore dhe me objekte konkrete, si dhe demonstrime të proceseve të punës që trajton moduli. Rekomandohet të përdoren metodat e lojës me role dhe e simulimit.
- Kursantët duhet të angazhohen në veprimtari konkrete në mjediset e punës në repartin e estetikës. Atyre duhet ti jepen detyra praktike për të realizuar trukime të llojeve të ndryshme, me teknika të ndryshme, fillimisht të mbikqyrur dhe më pas, në mënyrë të pavarur. Kursantët duhet të nxiten që të diskutojnë në lidhje me detyrat që kryejnë dhe proceset e punës që vëzhgojnë.
- Gjatë vlerësimit të kursantëve duhet të vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së shprehive praktike që parashikohen në këtë modul.
- Realizimi i pranueshëm i modulit do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të realizimit të specifikuara për çdo rezultat të të mësuarit.

---

**Kushtet e  
e domosdoshme  
për realizimin e  
modulit**

Për realizimin si duhet të modulit është e domosdoshme të sigurohen mjediset, veglat, pajisjet dhe materialet e mëposhtme:

- Klasë mësimore e pajisur me mjete dhe materiale pamore.
  - Mjedise reale të punës në qendër estetike.
  - Komplet i materialeve, veglave, pajisjeve dhe instrumenteve të punës në qendër estetike.
  - Produkte të ndryshme që përdoren për trukimin.
  - Kataloge, rregullore, manuale, udhëzuesa, materiale të shkruara në mbështetje të çështjeve që trajtohen në modul..
-